



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:046162

Datë: 16.09.2024

Numri i dokumentit: 06163240

KPPP.nr. 470/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Pro Biznis SH.P.K., me numër të biznesit 71356922 dhe seli në Viti, Sadovinë e Cerkezeve, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Valmir Marevci, avokat nga Lipjani, kundër debitorit Andi Group 2004 Sh.P.K., me numër unik identifikues 811291046 dhe seli në Gjilan, rr. "Abdullah Tahiri", të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fadil Sinanaj, avokat nga Gjilani, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 773/22, i datës 21.12.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Bardh Tasholli nga Ferizaj, jashtë seancës me datë 16.09.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Andi Group 2004 Sh.P.K., ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 773/22 i datës 21.12.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Bardh Tasholli, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Pro Biznis SH.P.K., me datë 21.12.2022 ka lëshuar urdhrin P.nr. 773/22, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve: Faturë nr. 092100033, e datës 21.09.2022; Faturë nr. 092100032, e datës 21.09.2022; Faturë nr. 092100031, e datës 21.09.2022; Faturë nr. 092100030, e datës 21.09.2022; Faturë nr. 010050021, e datës 05.10.2022; Faturë nr. 010050020, e datës 05.10.2022; Faturë nr. 010050019, e datës 05.10.2022 dhe Faturë nr. 010120016, e datës 12.10.2022, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas pranimit të këtij urdhri në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura t'ia paguaj kreditorit shumën prej 2,397.85 EUR (dy

mijë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë euro e tetëdhjetë e pesë cent), si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore dhe shpenzimet për përpilimin e propozimit për përmbartim në shumë prej 104.00 EUR.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbartimor, me arsyetimin se vlera e faturave mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbartimor nuk përputhet me kartelën financiare, ashtu që borxhi i kërkuar nga kreditori është shumë më i madh sesa vlera reale e borxhit. Ka shtuar se ka bërë pagesa të vazhdueshme ndaj kreditorit, si dhe është dashur që shuma në secilën faturë të zbritet në emër të bonusit vjetor në blerje, sipas kontratës përkatësisht aneks kontratës në mes të kreditorit dhe debitorit. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet, si dhe të obligohet kreditori që të kompensojë shpenzimet e procedurës përmbartimore për përpilimin e prapësimit në shumë prej 312.00 EUR.

Kreditore, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetimin se shuma sipas faturave mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbartimor paraqet vlerën e pa paguar nga ana e debitorit. Ka shtuar se debitori ka qenë i njoftuar për borxhin dhe se i është dhënë afat shtesë për përmbushjen e detyrimit, mirëpo i njëjti nuk ka përmbushur detyrimin ndaj kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkak që si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditore dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 092100033, e datës 21.09.2022; Fatura nr. 092100032, e datës 21.09.2022; Fatura nr. 092100031, e datës 21.09.2022; Fatura nr. 092100030, e datës 21.09.2022; Fatura nr. 010050021, e datës 05.10.2022; Fatura nr. 010050020, e datës 05.10.2022; Fatura nr. 010050019, e datës 05.10.2022 dhe Fatura nr. 010120016, e datës 12.10.2022, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit e pasqyruar tek pranuesi i secilës faturë, e po ashtu të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si të tilla paraqesin bazë për lejimin e përmbarimit pasi që janë të përshtatshme për përmbarim.

Në shqyrtimin e prapësimit të debitorit, Gjykata gjeti nuk është ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për t'i mbështetur pretendimet e paraqitura, e rrjedhimisht nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 470/24, datë 16.09.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.